

## S T A T U T I

### I SHOQERIS NDERTUESE "IMAG" IMPORT EKSPORT (ORTAK I VETEM)

#### FORMIMI

#### N E N I 1

Ne baze te ligjit nr.7512 dt.10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen eprones private te nismes se lire, te veprimtaris private te pavarur dhe privatizimit" dhe ligjit nr.7638 dt.19.02.1992, per shoqerit tregtare si dhe nenit 64te ligjit nr.7667 dt.28.08.1993 per rregjistrimin e shoqerive ne rregjistrine tregtar me vullnetin e tij te lire formohet shoqeria ndertuese "Imag" importe eksporte e themeluar nga ortaku i vetem z.Agim Ago i biri Kadriut d.lindjes me 1.07.1970 banues ne lagjen Vullnetari te qytetit Elbasan.

#### N E N I 2

Selia e shoqeris ndodhet ne lagjen "28 Nentori"te qytetit Elbasan. Shoqeria mund te hape edhe vendqendrim te tjera te dyta ,operative ,filiale, perfaqesi ne te gjithë territorin e vendit dhe jashte tij.

#### K O H E ZGJATJA

#### N E N I 3

Kohezgjatja e veprimtaris ekonomike te shoqeris eshte mbi 10(dhjete)vjete dhe mund te shperbehet ne çdo kohe.

#### OBJEKTI I VEPRIMTARIS

#### N E N I 4

Veprimtaria ndertuese dhe tregtare e shoqeris "Imag" eshte si vijon:

a- Ne fushen e zbatimit te objekteve.

Ne fushen e zbatimit te objekteve kjo shoqeri nderton, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj, dhe kompletme e insaltme ne to, punime restaurimi, punime dheu, murature, betoni, b/arme te shtresave te rugeve, ndertime vepra arti, hekurudhore e rrugore, punime te mirmbajtjeve te traseve, ujsjellsa, kanalizime, rezorvuare, impjante vaditese dhe punime karpienterie metal

b -Ne fushen e tregtis

Ne veprimtarin tregtare kjo shoqeri tregton: Tregtime te artikujve te ndryshem industrial ushqimor, produkte bujqesore industriale, materiale ndertimi me shumice e pakic, importe e eksporte.

#### N E N I 5

Shoqeria ndertuese "Imag" import-eksport mund te ndryshoj emrin,selin si dhe objektin e veprimtaris se saj sipas vendimeve qe do te marre pronari i saj.

KAPITALI I SHOQERISE

N E N I 6

Kapitali fillestar i shoqeris eshte 100,000(njeqindmije)leke i formuar ne masen e plote nga ortaku i vetem.

N E N I 7

Kapitali fillestar i shoqeris mund te shtohet ose pakesohet sipas vendimeve qe do te marre ortaku i vetem.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

N E N I 8

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te normave qe permbane ky statut dhe ato te legjistacinit Shqiptar ne fuqi. Shoqeria fiton zotsin per te vepruar me rregjistrimin e saj si persone juridik ne gjykaten e Tiranes dhe ndersa aktivitetin e saj me rregjistrimin ne zyren e tatimeve.

N E N I 9

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtjen: Shoqeria ndertuese "Imag" import-eksport

N E N I 10

Shoqeria vepron ne rregjistrin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet. Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saja kontaraktore brenda kapitalit te saj. Ortaku i vetem mbarte rrezikun e veprimtaris e shoqeris ne nivelin e shumes se mjeteve te investuara ne shoqeri.

N E N I 11

Shoqeria eshte prone e themeluesit te saj. Ajo merr vendime ne zbatim te ligjeve ne fuqi dhe sipas ketij statuti , te cilat jane te deturueshme per tu zbatuar nga te gjithë punonjesit ne kete shoqeri.

N E N I 12

Ortaku i vetem sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e veprimtaris se shoqeris emron drejtuesin teknik dhe administratorin si dhe punsone punonjes te veprimtarive te ndryshme ekonomike te permendura ne nenin 4te ketij statuti

N E N I 13

Ortaku i vetem i shoqeris ,drejtuesi teknik dhe administratori i ngarkuar prej tij jane te veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e zakonshem dhe te jasht-zakonshem te shoqeris pa asnje lloj kufizimi. Ata kane mundesi te kryejne te gjitha aktet qe konsiderohen te nevojshme per arrijene qellimeve te shoqeris. ~~At~~ **Ortaku** te drejte midis te tjerash te blejne e kembejne pasuri te lidhen me shoqeri te tjera te vendit ose te huaja, te kryejne çdo lloje veprimi prane te gjitha zyrave private apo shtetore qe kane te bejne me garancit ,hipotekat. Te kryejne prane instuticioneve bankare e financiare veprime depozitimi,kreditimi pagesa arktime. Ne keto rste administratori i ngarkuar ka per detyre te njoftoj e te jape llogari ortakut te vetem.

N E N I 14

Perfaqesimi i shoqeris i perket ortakut te vetem si dhe drejtuesit teknik

*[Handwritten signature]*

e administratorit te ngarkuar prej tij. Ata kane te drejten e perfaqesimit te shoqeris ne organet gjyqesore e administrative te caktoj ete pushoj avokat si dhe ekspert teknik per çdo problem.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

N E N I 15

Veprimet ekonomike financiare te shoqeris mbyllen me 31dhjetor te çdo viti. Ne fund te çdo periudhe ushtrimore administratori nxjerr bilancin kontabel te shoqeris me llogarin fitim humbje, mbeshtetur ne ligje dhe rregulle te mbajtjes se kontabilitetit nga subjektet private percaktuar nga organet kompetente te sistemit fiskal. Bilanci kontabel miratohet nga ortaku ivetem i cili vendos per krijimin e fondeve te ndryshme te nevojshme per zhvillimin e garancin e veprimtaris se shoqeris ,fondin e akumulimit, fondin rezerve etje.

N E N I 16

Te ardhurat neto pas veçimit te fondeve ligjore te permendura me sipër dhe shlyerjen e detyrimeve fiskale nga fitimii mbesin per perdorim ortakut te vetem

SHPERNDARJA E SHOQERIS

N E N I 17

Shperndarja shoqeris mund te vije ne çdo kohe dhe per çfardo shkak si humbja e kapitalit pamundesi veprimtarie etje. Ne keto raste ortakut i vetem vendos mbi menyren e likujdimit dhe cakton nje ose me shume likujdatore. Keta bejne kujdes qe shoqeria te me pare detyrimet qe u ka personave tret fizik e juridik.

DISPOZITAT E PERGJITHSHME

N E N I 18

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotsimit nga ortakut i vetem dhe ligjeve perkatese Shqiptare.

N E N I 19

Ky statut perpilohet ne 4 kopje per te ju shperndar organeve kompetente, ndersa nje kopje mbetet si pjese perberse dokumentacinit te themelimit te shoqerise.

ADMINISTRATOR DHE ORTAKU I VETEM

Agim Ago



REPUBLIKA E SHQIPERISE


NOTERIA

Nr. 5385 REP

Nr. \_\_\_\_\_ KOL.

V E R T E T I M

Sote me dt. 27/11/1998 ne zyren e noteris dhe perpara meje u paraqit personalish Agim Ago, i biri i Kadriut banues ne lagjen vullnetari te qytetit te Elbasanit madhor dhe iafta per te kryer veprime juridike, Shtetsia Shqiptare i cili mu be i njohur ne baze te leternjoftimit qe me paraqiti dhe me deklaroi se sa me sipër eshte shkruajtur konforme vullnetit te tij te lire. Nenshkrimi i tije u vertetua nga une noteria.



NOTERJA  
MAJLINDA LATO



AKT - THEMELIMI

I SHOQERIS NDERTUESE "IMAG" IMPORT -EKSPORT

Sot me dt. . 1998 une i quajturi Agim Ago, i biri i Kadriut d.lindjes 01.07.1970, lindur ne Floq te rrethit Elbasan dhe banues ne lagjen Vullnetari te qytetit Elbasan themeloj shoqerin si ortak i vetem.

**N E N I 1**

Shoqeria emerohet ndertuese "Imag" import - eksport.

**N E N I 2**

Selia e shoqeris ehte ne lagjen 28 Nentori te qytetit te Elbasanit.

**N E N I 3**

Shoqeria do kete nje aktivitet mbi 10 vjet dhe mund te shperbehet ne çdo kohe.

**N E N I 4**

Shoqeria ka per aktivitet te saj:

a - Ne ndertim

- Punime dheu, murature, betoni, b/arme, punime shembjesh masive.
- Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etje, dhekompletime me insaltime te nevojshme per to. - Punime restaurimi. - Vepra B/arme te veçanta.
- Punime te shtresave te rrugeve. - Ndertime vepra arti rrugore e hekurudhore.
- Punime te mirmbajtjeve te traseve. - Ujsjellsa,kanalizime,rezorvuar impiante vaditeseetje. - Punime karpentierie metalike.

b- Ne tregti

- Tregtim te artikujve te ndryshem industrial e ushqimor , produkte bujqesore e blektorale, fruta perime me shumic e pakic import - eksport.
- Prodhim perpunim e tregtim te materileve te ndertimit import-eksport.

**N E N I 5**

Kapitali fillestar i shoqeris eshte 100.000(njeqindmije) leke.

ADMINISTRATOR E ORTAKU I VETEM


Agim Ago

REPUBLIKA E SHQIPERIS

NOTERIA

Nr. 5385 REP \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_ KOL. \_\_\_\_\_



V E R T E T I M

Sot me dt. 27/4/1998 ne zyren e noteris dhe perpara meje noteres u paraqit personalisht Agim Ago i biri i Kadriut , banues ne lagjen "Vullnetari" te qytetit Elbasan, madhor dhe i afte per te kryer veprime juridike, shtetesia Shqiptare i cili mu be e njohur ne baze te leternjoftimit qe me paraqiti dhe me deklaroi se sa me siper eshte shkruajtur konforme vullnetit te tije te lire. Nenshkrimi i tije u vertetua nga une noteria.

